

UDHËZIM
Nr. 11, datë 13.3.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.5.2010, “PËR ADMINISTRIMIN DHE DOKUMENTIMIN E PROCEDURAVE TË PAJISJEVE FISKALE”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007, “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 16, datë 3.5.2010, “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

Pika 15.4 e udhëzimit nr. 16, datë 3.5.2010, ndryshon si më poshtë:

15.4 Procedura e shitjes dhe e lëvizjes së karburanteve nga Magazinat Doganore/Fiskale.

15.4.1 Procedura e tregtimit të karburanteve nga shoqëritë sh.a., te subjektet e tregtimit me pakicë (sh.p.k.)

Tregtimi i karburanteve nga Magazina Doganore/Fiskale në pikat e tregtimit me pakicë do të kryhet në çdo rast nëpërmjet lëshimit të faturës tatimore, e cila shoqëron sasinë e karburantit të shitur. Sasia e karburantit që del nga magazina evidentohet nëpërmjet kalimatësave, të cilët kontrollohen periodikisht nga DPM-ja. Në momentin e daljes nga Magazina Doganore/ Fiskale, sasia e karburantit të shitur, përveç faturës tatimore, shoqërohet detyrimisht edhe me kuponin tatimor, i cili lëshohet nga pajisja fiskale. Kuponi i bashkëngjitet faturës tatimore për çdo dalje të karburantit (shitje të tij) dhe e shoqëron faturën tatimore gjatë të gjithë lëvizjes (transportit) nga pika e daljes nga Magazina Doganore/Fiskale, pika e shitjes me shumicë, deri në vendin e shkarkimit të karburantit në depozitat e subjektit blerës. Ai mbahet i tillë i bashkëngjitur me faturën tatimore nga blerësi.

Kuponi tatimor, i cili do t'i bashkëngjitet faturës tatimore të shitjes, duhet të përmbajë detyrimisht të regjistruar të gjitha të dhënat e kërkuara nga ky udhëzim por domosdoshmërisht të ketë referencën e faturës së lëshuar.

Subjektet e shitjes së karburantit nga Magazina Doganore/Fiskale (pika të shitjes me shumicë), janë të detyruara të raportojnë çdo ditë, me mbylljen e raportit tatimor ditor në pajisjen fiskale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me këtë udhëzim. Doganieri kontrollon në daljen e magazinës nëse kuponi tatimor i është bashkëngjitur faturës tatimore dhe nuk lejon daljen e karburantit nga Magazina Doganore/Fiskale pa u lëshuar (prerë) kuponi tatimor nga pajisja fiskale e instaluar te kalimatësi.

Subjektet transportuese të karburantit, pas daljes nga Magazina Doganore/Fiskale, qofshin këto thjesht subjekte transportuese, në pronësi të subjektit blerës apo shitës, apo vetëtransportuese, detyrohen të mbajnë të bashkëngjitur me faturën tatimore edhe kuponin tatimor që i përket blerjes së karburantit që po transportohet. Mosparaqitja gjatë kontrollit e dokumentacionit sa më sipër (faturë dhe kupon tatimor) penalizohet si moslëshim fature, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Çdo lëvizje e karburantit pa lëshimin e kuponit tatimor krahas faturës tatimore, ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe penaltete tatimore subjektin shitës me shumicë. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi administrative, punonjësin e shërbimit doganor në vendin e daljes së karburantit nga Magazina Doganore/Fiskale, nëse ai nuk kontrollon lëshimin e kuponit tatimor.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet strukturave të tyre, kryejnë kontrole të vazhdueshme e të përbashkëta për zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi.

15.4.2 Procedura e tregtimit të karburanteve nga Magazina Fiskale e prodhuesit, te Magazina Fiskale e Blerësit.

Në rastin kur karburantet lëvizin nga Magazina Fiskale e Prodhuesit, te Magazina Fiskale e Blerësit, ky i fundit pajiset nga shitësi me faturë tatimore dhe kupon tatimor të gjeneruar nga pajisja fiskale. Blerësi shkarkon sasinë e karburantit të blerë në magazinën e tij fiskale dhe me pas evidenton me faturë dhe kupon tatimor çdo shitje për të tretë.

15.4.3 Procedura e lëvizjes së karburanteve nga Magazina Doganore e shoqërive të tregtimit me shumicë (sh.a.) te Magazinat Fiskale pronë e tyre.

Karburanti del nga magazina doganore me fature shoqërimi sipas standardit të miratuar nga DPT-ja, së cilës i bashkëngjitet detyrimitsh kuponi tatimor i pajisjes fiskale për sasinë e nxjerrë nga kalimatësi, por domosdoshmërisht duhet të ketë referencën e faturës së shoqërimit të lëshuar. Me hyrjen e karburantit në magazinën e shoqërisë, fatura e shoqërimit, së bashku me kuponin tatimor i bashkëngjitet fletëhyrjes së magazinës së shoqërisë. Kjo lëvizje nuk konsiderohet shitje nga ana e shoqërisë së tregtimit me shumicë (sh.a.) pasi ajo është një lëvizje e brendshme e saj dhe për këtë arsye vlera e kuponit tatimor që shoqëroi faturën e shoqërimit nuk do të raportohet si shitje në raportin ditor të shitjeve të shoqërisë (pra nga shitjet gjithsej ky kupon do të zbritet).

Edhe në këtë rast, zbatohen të njëjtat penalitete sikurse në rastin e mësipërm të tregtimit të karburanteve nga magazinat doganore te pikat e tregtimit me pakicë në rastet e shkeljeve të procedurës së pajisjes me dokumentacionin e kërkuar, për vetë shoqërinë, transportuesin dhe punonjësën e shërbimit doganor.

Pika 15.5 ndryshon si më poshtë:

15.5 Procedura e importimit të karburanteve nga shoqëritë (sh.a.) nëpërmjet transportit me mjete tokësore (autobote), zhdoganimi i të cilave bëhet nëpërmjet pikave të kalimit kufitar tokësor .

15.5.1. Në këto raste, informacioni mbi sasinë e karburantit të zhdoganuar gjenerohet nga të dhënat që transferohen periodikisht cdo 24 orë nga Administrata Doganore. Në rastet kur subjekti importues e shkarkon karburantin në magazinën e vet fiskale, çdo dalje e mëvonshme shoqërohet me kuponin e pajisjes fiskale dhe me faturën tatimore apo dokumentin shoqërues sipas rastit, kur dalja nga magazina fiskale është shitje për të tretë, apo subjekti e çon karburantin në pikën e vet të tregtimit me pakicë.

Në rastet kur subjekti importues nuk e shkarkon karburantin e importuar në magazinën e tij fiskale, por e shet direkt te subjekte të tregtimit me pakicë, për sasinë e shitur lëshon faturë tatimore, e cila përmban të njëjtën sasi karburanti të shitur, sikurse është pasqyruar në dokumentacionin e importit. Në rastet kur kryhen disa shitje, shuma e tyre duhet të korrespondojë me të dhënat e sasisë së importuar.

Për çdo shitje sipas kësaj skeme, në sistemin e raportimit *online* të DPT-së, krijohen llogari të siguruar me “emër përdoruesi”, “fjalë sekrete” dhe “firmë elektronike”. Shitësi kryen procedurën e deklarimit në serverin *online* për çdo shitje të sasisë së karburantit në pikat e tregtimit me pakicë sh.p.k., si dhe pajiset nga DPT-ja me një dokument zëvendësues të kuponit tatimor.

Autoriteti përgjegjës tatimor, në bashkëpunim me atë doganor, mbikëqyr periodikisht sasinë e deklaruar në shitje nga shoqëritë SH.A. në drejtim të shoqërive SH.P.K., duke bërë kontrole të dedikuara të inventarit dhe të sasive të shitura me pakicë nga shoqëritë SH.P.K.

15.5.2. Procedura e tregtimit nëpërmjet rishitësit të karburanteve nga magazina fiskale e prodhuesit, te pika e shitjes me pakicë (sh.p.k.) e blerësit.

Në rastin kur karburanti blihet nga kompania SH.A. që është rishitëse, dhe lëviz nga magazina fiskale e prodhuesit (shitësit) te pika e shitjes me pakicë (sh.p.k.) e karburanteve (blerësit fundorë), por lëvizja e mallrave nëpërmjet transportit nuk kryhet në drejtim të personit të tatueshëm blerës-rishitës, por në drejtim të një personi të tretë (blerësi fundor), rishitësi blerës do të pajiset në magazinën tatimore të prodhuesit me faturë tatimore dhe kupon tatimor të gjeneruar nga pajisja fiskale e prodhuesit.

Kompania rishitëse SH.A., për sasinë e shitur te blerësi fundor, lëshon faturë tatimore, e cila përmban të njëjtën sasi karburanti të shitur, sikurse është pasqyruar në dokumentacionin e lëshuar nga prodhuesi (fatura dhe kuponi tatimor). Në rastet kur kryhen disa shitje, shuma e tyre duhet të korrespondojë me të dhënat e sasisë së blerë te prodhuesi sipas faturës dhe kuponit të lëshuar nga ai.

Për çdo rishitës sipas kësaj skeme, në sistemin e raportimit *online* të DPT-së, krijohen llogari të siguruar me “emër përdoruesi”, “fjalë sekrete” dhe “firmë elektronike”. Rishitësi kryen procedurën e deklarimit në serverin *online* për çdo rishitje të sasisë së karburantit në pikat e tregtimit me pakicë sh.p.k., si dhe pajisen me një dokument zëvendësues të kuponit tatimor.

Autoriteti përgjegjës tatimor, mbikëqyr periodikisht sasinë e deklaruar në shitje nga prodhuesi i karburanteve për shoqëritë SH.A., si dhe shitjet e këtyre të fundit në drejtim të shoqërive SH.P.K., duke bërë kontrole të dedikuara të inventarit dhe të sasive të shitura me pakicë nga shoqëritë SH.P.K.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

Dokumenti zēvendēsues i kuponit tatimor

1. Tatimpaguesit pajiset me user name password nga Drejtoria e TI ne DPT
2. Me marrjen e userit tatimpaguesi fillon deklarimin në faqen e tij në programin e paisjeve fiskale.

Në dokumentin zëvendësues të kuponit tatimor shfaqet:

deklaruesi,

destinazioni,

produktet

targa e mjetit

3. Nr.serial i dokumentit zëvendësues të kuponit tatimor është unik për çdo kupon dhe gjenerohet nga programi i paisjeve fiskale.
4. Administrata tatimore në programin e paisjeve fiskale monitoron,verifikon dhe kontrollon të gjitha deklaratimet e tatimpaguesve që deklarojnë me dokumentin zëvendësues.

Pamja e deklarimeve në programin e paisjeve fiskale për tatimpaguesit që përdorin dokumentin zëvendësues.

[illegible]

